

V E N D I M
Nr.412, datë 20.5.1996

PËR NGRITJEN E KOMITETIT KOMBËTAR PËR DROGËN

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të krijohet Komiteti Kombëtar për Drogën, si organ ndërdikasterial i kryesuar nga zëvendëskryeministri dhe i përbërë nga titullarët e ministrive dhe institucioneve, me miratim të Kryetarit të Këshillit të Ministrave. Komiteti Kombëtar për Drogën do të ketë si objekt pune mbikëqyrjen e zbatimit të dërgimit të të dhënave të ndryshme për drogën dhe, mbi bazën e të dhënave, do të nxjerrë përfundimet përkatëse.

2. Për realizimin e detyrave dhe objektivave të caktuara nga Komiteti Kombëtar për Drogën krijohet Qendra Kombëtare e Sistemit të Informacionit për Drogën pranë Institutit të Shëndetit Publik, në vartësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit.

3. Qendra Kombëtare e Sistemit të Informacionit për Drogën do të grumbullojë e përpunojë të dhënat për drogën në Shqipëri dhe do të përgatisë materialin përkatës për Komitetin Kombëtar për Drogën.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi